Në rastin kur kandidati/ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, në vend të Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit do të paraqitet vendimi i Gjykatës për regjistrimin si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
 - a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
 - b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore , të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kriteret (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionale ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këtë kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendur.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4; **-jo e aplikueshme**
- b. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- c. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- ç. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Vërtetim nga Dega e tatim taksave për xhiron mesatare gjatë tre viteve të fundit (2014;2015;2016) me një vlerë sa fondi limit.
- b. Operatori ekonomik duhet të zoterojë vlerën monetare prej 10% të fondit limit e cila do të mbulojë shpenzimet paraprake për fillimin e zbatimit të kontratës. Kjo vërtetohet me anën e një Deklarate të Gjendjes Financiare të tij të leshuar nga një ose me shume banka jo me shume se 20 dite përpara dates se hapjes se procedures se tenderit.
- c. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e leshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. (muaji Korrik 2017 i likujduar)

2.3 Kapaciteti teknik:

- a. Furnizime të ngjashme në një vlerë prej **40%** të fondit limit për të cilën OE merr pjese, furnizime këto të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit ekonomik Kur kontrata është realizuar me entet publike, subjekti ofertues duhet ta shoqerojë ato me vërtetime të leshuara nga një ent publik, ose/dhe fatura tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b. Çertifikatë ISO të vlefshme, për prodhuesin/t e artikujve të ofruar ,te perkthyer dhe noterizuar.

- c. Ofertuesi duhet te paraqese Çertifikate konformiteti CE, ose deklartë konformiteti per produktet nga prodhuesi i tyre për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit te tyre,te perkthyer dhe noterizuar . Nga kjo kerkese perjashtohen artikujt nr. (30 -39).
- d. Deklarate mbi origjinen e mallit (ku te percaktohen vendi i prodhimit dhe firma prodhuese). Te plotesohet ne kolonat perkatese shtojcen 1 dhe ne aneksin e DST.
- e. Katalogë për të gjithë artikujt e ofruar, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin artikull. Katalogët duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose në anglisht. Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor te percaktuar ne formularin e ofertes. Kataloget do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.
- f. Deklarate per afatin e skadences sipas përcaktimeve në DST

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.



Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se:


- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit _____

Nënshkrimi

Vula



Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Nr	Kodi I artikullit	EMERTIMI	Specifikimet teknike	Lloji i ambllazhit	Njesia matese	SASIA	Kompania prodhuese	Origjina e Produktit	Afati I levrimit
1		Kit per vetemarrjen e materialit cervikal	50 tampone dhe terren transporti per vetemarrjen e kampioneve nga cerviksi	50 teste/kit	kit	19			
2		Kit permarrjen e materialit cervikal	50 furca cervikale dhe terren transporti per kampionet e marra nga cerviksi	50 test/kit	kit	5			
3		Kit per tipizimin e HPV-se	I bazuar ne teknologjine PCR. Te identifikojë 3 tipe HPV me risk te larte: 16/18/45/. Metodologjia Hybrid Capture	96 teste/kit	kit	18			
4		Kit per identifikimin e HPV-se me risk te larte dhe te ulet	I bazuar ne teknologjine Hybrid Capture 2. Te identifikojë tipet HPV me risk te larte: 16/18/31/33/35/39/45/51/52/56/58/59/68 dhe tipet HPV me risk te ulet: 6/11/42/43/44. Me sensitivitet klinik mbi 94%.	96 teste/kit	kit	1			

5	Kit per identifikimin e HPV-se me risk te larte	I bazuar ne teknologjine Hybrid Capture 2. Te identifikojte tipet HPV me risk te larte: 16/18/31/33/35/39/45/51/52/56/58/59/68.	96 teste/kit	kit	17			
6	Hantan Virus ELISA IgM	ELISA kualitative per zbulimin e antitropave IgM ndaj Hantan virus ne serum human. Ky test perdor nje perzjerje antigenesh Hantavirus.kiti permban nje pllake me 96 gropeza dhe te gjitha reagentet dhe kontrollet e nevojshem.	96 test/kit	kit	2			
7	Hantan Virus ELISA IgG	ELISA kualitative per zbulimin e antitropave IgG ndaj Hantan virus ne serum human. Ky test perdor nje perzjerje antigenesh Hantavirus.kiti permban nje pllake me 96 gropeza dhe te gjitha reagentet dhe kontrollet e nevojshem.	96 test/kit	kit	2			
8	ELISA West-Nile IgG	West-Nile ELISA IgG kiti perfshin te gjitha reagentet e nevojshem dhe kontrollet e nevojshem	96 test/kit	kit	2			
9	ELISA capture West-Nile IgM	West-Nile Capture ELISA IgM kiti perfshin te gjitha reagentet e nevojshem dhe kontrollet e nevojshem	96 test/kit	kit	2			
10	Hbs Ag	ELISA	96 teste/kuti	kit	11			
11	Anti HIV 1/2Ag/Ab (gjenerate e katert)	ELISA	96teste/kit	kit	10			
12	Anti HIV1	Western Blot, Test konfirmues per HIV1	18teste/kit	kit	8			
13	Anti HIV2	Western Blot, test konfirmues per HIV2	18teste/kit	kit	1			
14	HCV Ag-Ab Gjenerata e katert	ELISA	96teste/kit	kit	10			
15	Anti-HBcIgM	ELISA	96 teste/kit	kit	1			

16	HBeAg/antiHBe	ELISA	2X 96 teste/kit	kit	1		
17	Anti-HBc	ELISA	96 teste/kit	kit	2		
18	Anti-HBs	ELISA	96 teste/kit	kit	1		
19	Anti-HAV IgM	ELISA	96 teste/kit	kit	1		
20	Anti HEV IgG	ELISA	96 teste/kit	kit	1		
21	Anti HAV total	ELISA	96 teste/kit	kit	5		
22	Anti HDV total	Elisa	96 teste/kit	kit	1		
23	Kit Real-Time PCR per zbulimin e CCHF virus nepermjet teknologjise TaqMan® .	Kit per zbulimin e virusit CHF , teknologjia TaqMan, shkaketar i semundjes se ethes emoragjike te kongokrimese, ne mostrat e ndryshme humane , te permbaje te gjitha materialet e nevojshme (primer, probe,mixer,enzyme,kontroll pozitiv dhe negativ, kontrollin ë brendshem te ekstraktimit, uje) i aplikueshem per platformen ABI 7500 SD	96tests/kit	kit	1		
24	Kit Real-Time PCR per zbulimin e WNV virus nepermjet teknologjise TaqMan® .	Kit per zbulimin e virusit WNV Lineage 1 dhe Lineage 2. ne mostrat e ndryshme humane , te permbaje te gjitha materialet e nevojshme (primer, probe,mixer,enzyme,kontroll pozitiv dhe negativ, kontrollin ë brendshem te ekstraktimit, uje) i aplikueshem per platformen ABI 7500 SD,	96tests/kit	kit	1		

25	<p>Kit Multiplex Real-Time PCR per zbulimin e 21 viruseve respiratore nepermjet teknologjise TaqMan® .</p>	<p>Kit Multiplex Real-Time PCR per zbulimin e 21 viruseve respiratore (Flu A, Flu B, A/H1N1, Rhinovirus,Coronavirus NL63, Coronavirus 229E Coronavirus OC43,Coronavirus HKU1,Parainfluenza 2,Parainfluenza 3, Parainfluenza 4,Parainfluenza 1,Human metapneumovirus A/B,Bocavirus Mycoplasma pneumoniae,Respiratory Syncytial viruses A/B AdenovirusEnterovirus Parechovirus nepermjet teknologjise TaqMan® . Kiti perfshin kontrollin e brendshem dhe duhet te punoje me mostra humane, te jete I pershtatshem per platformen ABI 7500 SDS, te jene te perfshire ne kit, kontrollet pozitive per cdo patogen, One Step Real-Time PCR Master Mix dhe Enzima te pershtatur per te punuar me primerat dhe sonden e kitit.</p>	kit/64 reaksione	kit	1			
26	<p>Kit Real-Time PCR per MERS-CoV , nepermjet teknologjise TaqMan® .</p>	<p>Kit per zbulimin e virusit MERS-CoV, ne mostrat e ndryshme humane , te permbaje te gjitha materialet e nevojshme (primer, probe,mixer,enzyme,kontroll pozitiv dhe negativ, kontrollin ë brendshem te ekstraktimit, uje) i aplikueshem per platformen ABI 7500 SD</p>	48 teste/kit	kit	1			

27	Kit Multiplex Real-Time PCR per zbulimin e viruseve shkaktare te meningitit viral (enterovirus, HSV1, HSV2, varicela zoster, parechovirus), permjet teknologjise TaqMan®.	Kit Multiplex Real-Time PCR per zbulimin e viruseve Enterovirus/HSV1/HSV 2, varicella zoster.parechovirus, Kiti duhet te punoje me mostra humane, te jete I pershtatshem per platformen ABI 7500 SDS, te jene te perfshire ne kit, kontrolli i brendshem ,kontrollet pozitive per cdo patogen, One Step Real-Time PCR Master Mix dhe Enzima te pershtatur per te punuar me primerat dhe sonden e kitit.	kit/64 reaksione	kit	1			
28	Kit Multiplex Real-Time PCR per zbulimin e Norovirus G1, G2, astrovirus, rotavirus, adenovirus,sapovirus nepermjet teknologjise TaqMan®	Kit Multiplex Real-Time PCR per zbulimin e Norovirus G1, G2, Astrovirus, Rotavirus, Adenovirus,Sapovirus nepermjet teknologjise TaqMan®, Kiti duhet te punoje me mostra fekale humane, te jete I pershtatshem per platformen ABI 7500 SDS, te jene te perfshire ne kit, kontrolli i brendshem, kontrollet pozitive per cdo patogen, One Step Real-Time PCR Master Mix dhe Enzima te pershtatur per te punuar me primerat dhe sonden e kitit.	kit/64 reaksione	kit	2			
29	Kit per identifikimin e meningitit nga Meningococcus	kit aglutinimi	25 teste /kit	kit	1			
30	Kit mastermiksi per reaksionin one-step Real-Time PCR	2x universal one-step master mix e cila permban iTaq DNA polymerase, buffers, dhe ROX per normalizimin e dyes; reverse transcriptase; dhe uje nuclease-free ,per 500 reaksione x 20 µl reaksioni, 5 ml (5 x 1 ml)	500 reaksione /kit	kit	2			

Dokumentat Standarde të Tenderit

31	Viral RNA Mini Kit	Kit per purifikimin e acideve nukleike virale nga lengjet e trupit pa qeliza, me ane te kolonave te pajisura me membrana filtruese	250 teste /kit	kit	3		
32	One step Master Mix per real time PCR kit	Kit one step universal qe perdor sonden Taq eshte nje formulim I avancuar I cili ben te mundur amplifikimin e sekuencave gjenetike te targeteve te veshtire nepermjet kombinimit te 2X one step master mikse cila permban Taq DNA polimeraze , bufera te nevojshem , inhibitoret e reaksionit dhe ROX dye e nevojshme per normalizimin e qRT PCR si dhe duhet te permbaje reverse transkriptazen(50 mikrolitra)dhe ujin.	100 reksione/ku ti	kuti	1		
33	Kit maja per manipulimet ne biologji molekulare	Sterile, 200µl, pyrogenfree, sterile me filter me densitet te larte per mbrojtje nga aerosolet. Te certifikuara per DNase dhe RNase free. Kompatibile me pipetues Socorex dhe Ependorf	Kuti me 8 x 204 / rack	kuti	3		
34	Kit maja per manipulimet ne biologji molekulare	Sterile, 100µl, pyrogenfree, sterile me filter me densitet te larte per mbrojtje nga aerosolet. Te certifikuara per DNase dhe RNase free	Kuti me 10x 96 maja/ rack	kuti	2		
35	Kit maja per manipulimet ne biologji molekulare	Sterile, 1000µl, pyrogenfree, sterile me filter me densitet te larte per mbrojtje nga aerosolet. Te certifikuara per DNase dhe RNase free	Kuti me 10x 100 / rack	kuti	3		
36	Kit maja per manipulimet ne biologji molekulare	Sterile, 20µl, pyrogenfree, sterile me filter me densitet te larte per mbrojtje nga aerosolet. Te certifikuara per DNase dhe RNase free	Kuti me 10x 96 maja/ rack	kuti	3		
37	kit kapakesh me filetim	kapak per tubat e denatyrimit te HPV	kuti me 1000 kapak	kuti	2		

38	Test per identifikimin e Legjioneles	Legionella Urinary Antigen Card.	kuti 22 teste/kuti	kuti	2		
39	Kit Master Mix, Taq Probe 1-Step RT-qPCR ,	Ky kit bazohet ne formatin e sondes se hidrolizes taq man dhe siguron zbulimin e materialit gjenetik ne kohe reale nepermjet kombinimit te kryerjes se transkriptimit te kundert te materialit gjenetik dhe njekoheisht amplifikimit te tij ne nje reaksion te vetem duke perdorur nje RT master mix me perqendrim 50X si dhe nje tjeter master mix i cili permban sonden Taq i stabilizuar ne perqendrimin 2X , dUTP dhe qe duhet te permbaje te gjithë elementet e tjere te nevojshem per kryerjen e qPCR-se si dhe Dye reference carboxy-X-rhodamine (CXR) ne perqendrimin 30µM. i cili stabilizon kryerjen e reaksionit si dhe inhibitoret e reaksionit	200 reaksione/kit	kit	1		
		TOTALI					
		TVSH 20%					
		Totali me TVSH					

Afati i skadences e produkteve do te jete 6 - 8 muaj nga momenti i levrimit në magazinat e ISHP-së.

Skadencia duhet te jete e shenuar ne ambalazh dhe ambalazhi te jete i pershateshem sipas llojit te mallit te shoqeruar me etiketat dhe markim perkates

Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: <input type="checkbox"/> Mall: <input type="checkbox"/> Punë: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____



Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Nr	Kodi I artikullit	EMERTIMI	Specifikimet teknike	Lloji i ambalazhit	Njesia matese	SASIA	Afati I levrimit
1		Kit per vetemarrjen e materialit cervikal	50 tamponë dhe terren transporti per vetemarrjen e kampioneve nga cerviksi	50 teste/kit	kit	19	
2		Kit permarrjen e materialit cervikal	50 furca cervikale dhe terren transporti per kampionet e marra nga cerviksi	50 test/kit	kit	5	
3		Kit per tipizimin e HPV-se	I bazuar ne teknologjine PCR. Te identifikojë 3 tipe HPV me risk te larte: 16/18/45/. Metodologjia Hybrid Capture	96 teste/kit	kit	18	
4		Kit per identifikimin e HPV-se me risk te larte dhe te ulet	I bazuar ne teknologjine Hybrid Capture 2. Te identifikojë tipet HPV me risk te larte: 16/18/31/33/35/39/45/51/52/56/58/59/68 dhe tipet HPV me risk te ulet: 6/11/42/43/44. Me sensitivitet klinik mbi 94%.	96 teste/kit	kit	1	
5		Kit per identifikimin e HPV-se me risk te larte	I bazuar ne teknologjine Hybrid Capture 2. Te identifikojë tipet HPV me risk te larte: 16/18/31/33/35/39/45/51/52/56/58/59/68.	96 teste/kit	kit	17	
6		Hantan Virus ELISA IgM	ELISA kualitative per zbulimin e antitropave IgM ndaj Hantan virus ne serum human. Ky test perdor nje perzjerje antigenesh Hantavirus.kiti permban nje pllake me 96 gropeza dhe te gjithë reagentet dhe kontrollët e nevojshem.	96 test/kit	kit	2	

Dokumentat Standarde të Tenderit

7	Hantan Virus ELISA IgG	ELISA kualitative per zbulimin e antitropave IgG ndaj Hantan virus ne serum human. Ky test perdor nje perzjerje antigenesh Hantavirus.kiti permban nje pllake me 96 gropeza dhe te gjithë reagentet dhe kontrollet e nevojshem.	96 test/kit	kit	2
8	ELISA West-Nile IgG	West-Nile ELISA IgG kiti perfshin te gjithë reagentet e nevojshem dhe kontrollet e nevojshem	96 test/kit	kit	2
9	ELISA capture West-Nile IgM	West-Nile Capture ELISA IgM kiti perfshin te gjithë reagentet e nevojshem dhe kontrollet e nevojshem	96 test/kit	kit	2
10	Hbs Ag	ELISA	96 teste/kuti	kit	11
11	Anti HIV 1/2Ag/Ab (gjenerata e katert)	ELISA	96teste/kit	kit	10
12	Anti HIV1	Western Blot, Test konfirmues per HIV1	18teste/kit	kit	8
13	Anti HIV2	Western Blot, test konfirmues per HIV2	18teste/kit	kit	1
14	HCV Ag-Ab Gjenerata e katert	ELISA	96teste/kit	kit	10
15	Anti-HBcIgM	ELISA	96 teste/kit	kit	1
16	HBeAg/antiHBe	ELISA	2X 96 teste/kit	kit	1
17	Anti-HBc	ELISA	96 teste/kit	kit	2
18	Anti-HBs	ELISA	96 teste/kit	kit	1
19	Anti-HAV IgM	ELISA	96 teste/kit	kit	1
20	Anti HEV IgG	ELISA	96 teste/kit	kit	1
21	Anti HAV total	ELISA	96 teste/kit	kit	5
22	Anti HDV total	Elisa	96 teste/kit	kit	1
23	Kit Real-Time PCR per zbulimin e CCHF virus nepermjet teknologjise TaqMan® .	Kit per zbulimin e virusit CHF , teknologjia TaqMan, shkaketar i semundjes se ethes emoragjike te kongokrimese, ne mostrat e ndryshme humane , te permbaje te gjitha materialet e nevojshme (primer, probe,mixer,enzyme,kontroll pozitiv dhe negativ, kontrollin ë brendshem te ekstraktimit, uje) i aplikueshem per platformen ABI 7500 SD	96tests/kit	kit	1

Dokumentat Standarde të Tenderit

24		Kit Real-Time PCR per zbulimin e WNV virus nepermjet teknologjise TaqMan® .	Kit per zbulimin e virusit WNV Lineage 1 dhe Lineage 2. ne mostrat e ndryshme humane , te permbaje te gjitha materialet e nevojshme (primer, probe,mixer,enzyme,kontroll pozitiv dhe negativ, kontrollin ë brendshem te ekstraktimit, uje) i aplikueshem per platformen ABI 7500 SD,	96tests/kit	kit	1
25		Kit Multiplex Real-Time PCR per zbulimin e 21 viruseve respiratore nepermjet teknologjise TaqMan® .	Kit Multiplex Real-Time PCR per zbulimin e 21 viruseve respiratore (Flu A, Flu B, A/H1N1, Rhinovirus,Coronavirus NL63, Coronavirus 229E Coronavirus OC43,Coronavirus HKU1,Parainfluenza 2,Parainfluenza 3, Parainfluenza 4,Parainfluenza 1,Human metapneumovirus A/B,BocavirusMycoplasma pneumoniae,Respiratory Syncytial viruses A/BAdenovirusEnterovirus Parechovirus nepermjet teknologjise TaqMan® . Kiti perfshin kontrollin e brendshem dhe duhet te punoje me mostra humane, te jene I pershtatshem per platformen ABI 7500 SDS, te jene te perfshire ne kit, kontrollin pozitiv per cdo patogen, One Step Real-Time PCR Master Mix dhe Enzima te pershtatur per te punuar me primerat dhe sonden e kitit.	kit/64 reaksione	kit	1
26		Kit Real-Time PCR per MERS-CoV , nepermjet teknologjise TaqMan® .	Kit per zbulimin e virusit MERS-CoV, ne mostrat e ndryshme humane , te permbaje te gjitha materialet e nevojshme (primer, probe,mixer,enzyme,kontroll pozitiv dhe negativ, kontrollin ë brendshem te ekstraktimit, uje) i aplikueshem per platformen ABI 7500 SD	48 teste/kit	kit	1

Dokumentat Standarde të Tenderit

27	Kit Multiplex Real-Time PCR per zbulimin e viruseve shkaktyare te meningitit viral (enterovirus, HSV1, HSV2, varicela zoster, parechovirus), permjet teknologjise TaqMan®.	Kit Multiplex Real-Time PCR per zbulimin e viruseve Enterovirus/HSV1/HSV 2, varicella zoster.parechovirus, Kiti duhet te punoje me mostra humane, te jete I pershtatshem per platformen ABI 7500 SDS, te jene te perfshire ne kit, kontrolli i brendshem ,kontrollat pozitive per cdo patogen, One Step Real-Time PCR Master Mix dhe Enzima te pershtatur per te punuar me primerat dhe sonden e kitit.	kit/64 reaksione	kit	1
28	Kit Multiplex Real-Time PCR per zbulimin e Norovirus G1, G2, astrovirus, rotavirus, adenovirus,sapovirus nepermjet teknologjise TaqMan®	Kit Multiplex Real-Time PCR per zbulimin e Norovirus G1, G2, Astrovirus, Rotavirus, Adenovirus,Sapovirus nepermjet teknologjise TaqMan®, Kiti duhet te punoje me mostra fekale humane, te jete I pershtatshem per platformen ABI 7500 SDS, te jene te perfshire ne kit, kontrolli i brendshem, kontrollat pozitive per cdo patogen, One Step Real-Time PCR Master Mix dhe Enzima te pershtatur per te punuar me primerat dhe sonden e kitit.	kit/64 reaksione	kit	2
29	Kit per identifikimin e meningitit nga Meningococcus	kit aglutinimi	25 teste /kit	kit	1
30	Kit mastermiksi per reaksionin one-step Real-Time PCR	2x universal one-step master mix e cila permban iTaq DNA polymerase, buffers, dhe ROX per normalizimin e dyes; reverse transcriptase; dhe uje nuclease-free ,per 500 reaksione x 20 µl reaksioni, 5 ml (5 x 1 ml)	500 reaksione /kit	kit	2
31	Viral RNA Mini Kit	Kit per purifikimin e acideve nukleike virale nga lengjet e trupit pa qeliza, me ane te kolonave te pajisura me membrana filtruese	250 teste /kit	kit	3
32	One step Master Mix per real time PCR kit	Kit one step universal qe perdor sonden Taq eshte nje formulim I avancuar I cili ben te mundur amplifikimin e sekuencave gjenetike te targeteve te veshtire nepermjet kombinimit te 2X one step master mikse cila permban Taq DNA polimeraze , bufera te nevojshem , inhibitoret e reaksionit dhe ROX dye e nevojshme per normalizimin e qRT PCR si dhe duhet te permbaje reverse transkriptazen(50 mikrolitra)dhe ujin.	100 reksione/kuti	kuti	1

Dokumentat Standarde të Tenderit

33	Kit maja per manipulimet ne biologji molekulare	Sterile, 200µl, pyrogenfree, sterile me filter me densitet te larte per mbrojtje nga aerosolet. Te certifikuara per DNase dhe RNase free. Kompatibile me pipetues Socorex dhe Ependorf	Kuti me 8 x 204 / rack	kuti	3
34	Kit maja per manipulimet ne biologji molekulare	Sterile, 100µl, pyrogenfree, sterile me filter me densitet te larte per mbrojtje nga aerosolet. Te certifikuara per DNase dhe RNase free	Kuti me 10x 96 maja/ rack	kuti	2
35	Kit maja per manipulimet ne biologji molekulare	Sterile, 1000µl, pyrogenfree, sterile me filter me densitet te larte per mbrojtje nga aerosolet. Te certifikuara per DNase dhe RNase free	Kuti me 10x 100 / rack	kuti	3
36	Kit maja per manipulimet ne biologji molekulare	Sterile, 20µl, pyrogenfree, sterile me filter me densitet te larte per mbrojtje nga aerosolet. Te certifikuara per DNase dhe RNase free	Kuti me 10x 96 maja/ rack	kuti	3
37	kit kapakesh me filetim	kapak per tubat e denatyrimit te HPV	kuti me 1000 kapak	kuti	2
38	Test per identifikimin e Legjioneles	Legionella Urinary Antigen Card.	kuti 22 teste/kuti	kuti	2
39	Kit Master Mix, Taq Probe 1-Step RT-qPCR ,	Ky kit bazohet ne formatin e sondes se hidrolizes taq man dhe siguron zbulimin e materialit gjenetik ne kohe reale nepermjet kombinimit te kryerjes se transkriptimit te kundert te materialit gjenetik dhe njekohesisht amplifikimit te tij ne nje reaksion te vetem duke perdorur nje RT master mix me perqendrim 50X si dhe nje tjeter master mix i cili permban sonden Taq i stabilizuar ne perqendrimin 2X , dUTP dhe qe duhet te permbaje te gjitha elementet e tjere te nevojshem per kryerjen e qPCR-se si dhe Dye reference carboxy-X-rhodamine (CXR) ne perqendrimin 30µM. i cili stabilizon kryerjen e reaksionit si dhe inhibitoret e reaksionit	200 reaksione/kit	kit	1
		TOTALI			
		TVSH 20%			
		Totali me TVSH			

Afatet e lëvrimit: Duke filluar nga nënshkrimi i kontratës por jo me vone se 31 Dhjetor 2017

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Public Health Sector

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

¹ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.


Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. _____

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____



* * *

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Public Health Sector

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME **Mallrat – Tender i Hapur**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokurara me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Entit prokurues dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë shpërndarjen e funksioneve, kostot, dhe rrisqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktor.
- 2.4 “Lëvrimiti” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifrat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gazshme.
- 2.9 “Shërbimet në Lidhje me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet në Lidhje me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake më shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron materialet.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Pershtatshmeria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorezojë Mallrat me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, në se ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posacem të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në pajtim me kontratën në se ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për te cilin sherbejne zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Në se shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorezojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si te modelit ose kampionit.

Neni 9: Pershtatshmeria e Mallrave me Standartet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standarteve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet perkatese ose ne Standartet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktues.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër të kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standart Teknik perkates në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike ndërkombëtare te tanishme. Nëse nuk ekzistojnë Standarte Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike perkatese Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk do të jetë përgjegjës për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktues me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shiteshi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjesi per defekte te prones (Mallrave) per te cilat Autoriteti Kontraktor ishte ne dijeni ne momentin e lidhjes se kontrates ose nuk ishte ne dijeni per faj te tij, me perjashtim te rastit kur defektet kane te bejne me cilesine e Mallrave te specifikuar sipas kontrates ose perfaqsimin e reklames se shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

